

**MINISTRIA E EKONOMISË DHE PUNËS**

**UDHËZUES**

**për realizimin e Masës 5: Nxitje të projekteve novatore dhe bashkëpunuese në lidhje me  
specializimin e mençur, transformimin e gjelbër dhe digjital në heliksin e katërfishtë**

**nga**

**Programi për mbështetjen e industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë shoqërore për vitin  
2024**

**Shtator, viti 2024**

Në bazë të nenit 55, të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/2000, 44/2002, 82/2008, 167/2010 dhe 51/2011) dhe ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19, 110/19, 154/19, 121/2024) ministri i Ekonomisë dhe Punës miratoi:

## **UDHËZUES**

**për realizimin e Masës 5: Nxitje të projekteve novatore dhe bashkëpunuese në lidhje me specializimin e mençur, transformimin e gjelbër dhe digjital në një heliks të katërfishtë nga Programi për mbështetjen e konkurrencës së industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë shoqërore për vitin 2024**

### **1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Me Udhëzuesin për realizimin e Masës 5: Nxitje të projekteve novatore dhe bashkëpunuese në lidhje me specializimin e mençur, transformimin e gjelbër dhe digjital në heliksin e katërfishtë (në tekstin e mëtejme: Udhëzuesi), përcaktohen procedurat për përgatitjen dhe realizimin e Masës 5: Nxitje të projekteve novatore dhe bashkëpunuese në lidhje me specializimin e mençur, transformimin e gjelbër dhe digjital në heliksin e katërfishtë (në tekstin e mëtejme: Masa 5) të Programit për mbështetjen e konkurrencës së industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë shoqërore për vitin 2024 (në tekstin e mëtejme: Programi).

Udhëzuesi është hartuar me qëllim që të rregullohen hapat për përgatitjen dhe realitimin e Masës 5, që përfshin: procedurën e dhënies së mjeteve, mënyrat e mundshme të financimit të masës, përmbajtjen e Thirrjes publike për dhënien e mjeteve, mënyrën e promovimit, mënyrën e dhënies së fondeve, mënyrën e evaluimit të kërkesave të parashtruara, mënyrën e monitorimit të procesit të implementimit, njoftim, monitoring dhe evalim, si dhe procedurat e tjera që lidhen me dhënien e mjeteve në përputhje me këtë masë.

Udhëzuesi ndjek standardet ISO.

### **Përkufizimet**

Në Udhëzuesin përdoren përkufizime dhe sqarime me kuptimin e mëposhtëm:

"Aplikim" nënkupton të gjithë dokumentacionin që partnerët e projektit e parashtrojnë në Thirrjen Publike, duke përfshirë edhe formularin e plotësuar "Aplikimin e projektit" dhe formularin e plotësuar "Buxheti i Projektit".

"Partneri udhëheqës" është person juridik që përfaqëson partnerët e projektit (partneritetit) dhe i cili si i tillë ka detyrimin të parashtojë propozim-projektin, e nëse partneriteti merr vendim për

bashkëfinancim, të lidhë marrëveshje me MEP, të koordinojë zbatimin e projektit, të parashtrojë raport të detajuar për realizimin e projektit dhe të ushtrojë të gjitha detyrimet e tjera në përputhje me Marrëveshjen e nënshkruar për bashkëfinancim me MEP-në.

"Marrëveshja për bashkëfinancim" do të thotë marrëveshja midis MEP-së dhe Partnerit udhëheqës si përfaqësues i partneritetit, për të dhënë mjete në përputhje me Programin, Thirrjen publike për Masën 5 dhe procedurat e përcaktuara me Udhëzuesin.

"Komisioni për vlerësim" është komision i formuar nga ministri i Ekonomisë dhe Punës, në përputhje me Udhëzuesin dhe ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

"MEP" është Ministria e Ekonomisë dhe Punës e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

"MASH" është Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut

"Partnerët e projektit" janë persona juridikë ose organizata që, në bazë të Marrëveshjes së lidhur të partneritetit, aplikojnë me propozim-projekt të përbashkët në Thirrjen e hapur publike për bashkëfinancim të projekteve në përputhje me Programin dhe Masën 5.

"Propozim-projekti" është dokument me shkrim në të cilin është përshkruar projekti i propozuar dhe qëllimi i tij, rezultatet, si dhe të gjitha aktivitetet e nevojshme në mënyrë që të përfundohet projekti, duke përfshirë planin e aktiviteteve dhe buxhetin.

"Projekt" është aktiviteti i punës që ka qëllim të caktuar dhe shënon rend aktivitetesh që duhet të përfundohen brenda një afati të paracaktuar në mënyrë që të arrihet rezultat i caktuar.

"Rezultate të projektit" janë gjëra materiale dhe/ose jomateriale, informacione, raporte, produkte që janë rezultat i procesit zhvillimor ose njohurive të tjera (know-how) që kanë rezultuar nga zbatimi i aktiviteteve të projektit.

"Parapërzgjedhje" është faza e vlerësimit e kryer nga Komisioni për vlerësim, anëtarët e të cilit kanë detyrimin të shqyrtojnë propozim-projektet që kanë kaluar fazën e verifikimit administrativ dhe për të njëjtat të dorëzojnë vlerësime dhe mendime profesionale.

"Përzgjedhje" është faza e vlerësimit që zbatohet nga Komisioni për vlerësim, anëtarët e të cilit, nëpërmjet votimit për propozim-projektet që kanë kaluar fazën e parapërzgjedhjes, marrin vendim përfundimtar për bashkëfinancimin.

### **Qëllimi dhe përshkrimi i Masës 5**

Masa 5 realizohet në përputhje me Strategjinë e specializimit të mençur 2024-2027 dhe Planin e veprimit 2024-2025, Strategjinë industriale 2018-2027, Agjendën reformuese dhe Udhërrëfyesin për ekonominë cirkulare, e përmes Programit për konkurrencën e industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë shoqërore, ku parashikohet masë për nxitjen dhe mbështetjen e projekteve për vendosjen e dialogut dhe bashkëpunimit afatgjatë midis subjekteve afariste, institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve

publike, shoqatave civile dhe qytetarëve, e të cilat bazohen në hulumtim, zhvillim dhe inovacione për specializim të mençur.

Fokusi është në bashkëpunimin akademi-biznes dhe forcimin e infrastrukturës institucionale për hulumtim dhe zhvillim në përputhje me nevojat e sektorit të biznesit dhe në drejtim të implementimit të konceptit të specializimit të mençur, transformimit të gjelbër dhe digjital.

**Qëllimi** i Masës 5 është të nxisë zhvillimin e një kulture të bashkëpunimit midis akademisë, biznesit dhe faktorëve të tjerë të heliksit të katërfishtë, nëpërmjet krijimit të partneriteteve për transferimin e njohurive, bashkëpunimit, hulumtimit, zhvillimit, inovacioneve për specializim të mençur, që çon në konkurrencë më të madhe, zhvillimin e sektorit, zhvillimin e një produkti, procesi dhe/ose shërbimi inovativ, të ri ose të përmirësuar, komercializimin e rezultateve të hulumtimit të zbatuar brenda institucioneve të arsimit të lartë, respektivisht institucioneve hulumtuese-shkencore, ndërkombëtarizimin, etj.

**Lëndë** e Masës 5 është bashkëfinancimi i një pjese të kostove të iniciativave të reja për projekte hulumtuese dhe zhvillimore në lidhje me specializimin, transformimin e gjelbër dhe digjital në industrinë përpunuese. Nëpërmejt kësaj mbështetjeje inkurajohet zhvillimi dhe/ose vendosja e produkteve novatore, të reja ose të përmirësuar, ekologjike dhe digjitale, procese novatore, të reja ose të përmirësuar dhe modele biznesi, transferim i njohurive, ngritje të kapaciteteve të menaxhimit dhe të punësuarve për të zbatuar teknologji të reja, si dhe përfshirjen e hulumtuesve të rinj në projektet.

Të pranueshme për financim janë propozim-projektet nga fushat e definuara në Strategjinë e specializimit të mençur, si më poshtë:

- Bujqësi e mençur dhe ushqim me vlerë të shtuar më të lartë
- TIK
- Ndërtesa të mençura dhe materiale të qëndrueshme
- Industria 4.0
- Turizmi
- Energji për të ardhmen

### **Procedura për zbatimin e Masës 5**

Zbatimi i Masës 5, në përputhje me Udhëzuesin, zhvillohet përmes hapave të mëposhtëm:

- Përgatitja e Thirrjes publike dhe formularëve për aplikim (përfshirë formularin e Aplikimit të projektit dhe formularin e Buxhetit të projektit);
- Shpallje e Thirrjes publike
- Kontrolli administrativ i aplikimeve që kanë mbërritur;
  - Formimi i Komisionit për vlerësim;
  - Evaluimi i projekteve dhe vendimmarrja për bashkëfinancimin e projekteve bashkëpunuese në lidhje me specializimin e mençur, transformimin e gjelbër dhe digjital në fushën e industrisë përpunuese;
  - Lidhjen e marrëveshjeve të bashkëfinancimit;
  - Paguesa e mjeteve të dhëna financiare,

- Monitorimi i zbatimit të projekteve dhe vlerësimi i rezultateve të arritura.

## 2. KRITERET E PËRGJITHSHME PËR FINANCIM DHE BASHKËPUNIM

### Kriteret e përgjithshme të financimit

Për realizimin e Masës 5, sigurohen mjete nga Buxheti i RMV-së përmes Programit për mbështetjen e konkurrencës së Industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë shoqërore për vitin 2024.

Buxheti i përgjithshëm për bashkëfinancimin e projekteve në kuadër të Masës 5 përcaktohet nga Programi dhe Thirrja publike për dhënien e mjeteve për Nxitjen e projekteve novatore dhe bashkëpunuese në lidhje me specializimin e mençur, transformimin e gjelbër dhe digjital në heliksin e katërfishtë (në tekstin e mëtejme: Thirrja publike). Thirrja publike publikohet në ueb faqen e Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës.

Duke bashkëfinancuar propozim-projektet në kuadër të Masës 5, kompensohet një pjesë e kostove për implementimin e propozim- projekteve në fushën e specializimit të mençur në **shumën maksimale prej 50% dhe më së shumti deri në 3.000.000,00 denarë për çdo propozim-projekt** të aprovuar individual. Pjesa tjetër e mjeteve duhet të sigurohen nga partnerët e projektit.

Shuma e përgjithshme e bashkëfinancimit nga MEP-ja do të sigurohet menjëherë pas lidhjes së marrëveshjes së Partnerit udhëheqës me MEP-në. Shumën e bashkëfinancimit të tyre (minimalisht 50% të buxhetit të përgjithshëm), partnerët do të duhet ta arsyetojnë në raportet tremujore, në fund të çdo tremujori të zbatimit të projektit, si dhe në kuadër të Raportit përfundimtar të projektit.

Zbatimi i përgjithshëm i projektit, pagesa dhe shlyerja e mjeteve për realizimin e aktiviteteve të projektit bëhet përmes një **llogarie të dedikuar** të hapur për nevojat e projektit te Partneri udhëheqës.

Për realizimin me sukses të çdo aktiviteti të përmendur në raportet, duhet të ketë mbulim, respektivisht duhet të ketë dëshmi të realizimit të aktivitetit dhe pagesës së kryer. Si dëshmi konsiderohen: faturat, të shoqëruara me marrëveshje të lidhura, certifikatë të transaksioneve bankare, raporte, etj. Në rastet kur, në varësi të aktivitetit, mbulimet e mësipërme nuk janë të mjaftueshme, mund të kërkohen mjete të tjera dëshmuese.

Ndarja e mjeteve financiare nga MEP-ja për Masën 5 të Programit për mbështetjen e konkurrencës së industrisë përpunuese, në përputhje me Aktvendimin e KMK-së nr. 10-38 të datës 26.02.2024, paraqet ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore, i cili si ndihmë horizontale në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika (1) jepet nga MEP-ja, ku dhënia e saj lejohet si ndihmë për projekte hulumtuese dhe zhvillimore, në përputhje me nenin 8 paragrafi (2) të Ligjit për

kontrollin e ndihmës shtetërore dhe nenin 6 të Urdhëresës për kushtet dhe procedurën e dhënies së ndihmës horizontale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 03/14).

### **Bashkëpunimi i MEP-së me institucionet tjera, shoqatat e qytetarëve dhe/ose**

MEP-ja mund të realizojë Masën 5 në bashkëpunim dhe duke grumbulluar mjete nga institucione të tjera shtetërore ose projekte donatore. Gjithashtu mund të bashkëpunohet me ndihmë teknike të ofruar nga institucione dhe/ose donatorë të tjerë, e në mënyrë që të sigurohet sukses më i madh i masës dhe mbështetje më e madhe për projekte zhvillimore, të bazuara në bashkëpunimin e akademisë dhe biznesit.

Në rast të pjesëmarrjes së disa prej organizatave të mësipërme në realizimin e Masës 5, është e nevojshme që ato të nënshkruajnë Marrëveshje bashkëpunimi me MEP-në duke definuar mënyrën, respektivisht kushtet dhe kriteret për bashkëpunim dhe aktivitete të përbashkëta.

Në rast të vendosjes së bashkëpunimit me institucion dhe/ose donator tjetër, ata do të jenë të detyruar të respektojnë plotësisht rregulloret ligjore, aktet nënligjore, dispozitat e Udhëzuesit dhe Thirrjes publike, si dhe të gjitha rregulloret e tjera që lidhen me zbatimin e Masës 5.

Në rastin e bashkëfinancimit nga institucionet dhe/ose donatorët tjerë, mënyra e shlyerjes së fondeve që do të vijnë prej tyre, si dhe mënyrat e mentorimit do të rregullohen në marrëveshjen e Partnerit udhëheqës me MEP-në dhe/ose në marrëveshje të veçanta midis Partnerit udhëheqës dhe institucioneve të tjera.

Mjetet e marra nga MEP-ja mbi çdo bazë tjetër ose çdo formë tjetër të ndihmës shtetërore nuk janë të pranueshme si bashkëfinancim nga vetë partnerët e projektit.

### **3. PARTNERITETI DHE EKIPI I PROJEKTIT**

**Në përgjithësi për partnerët e projektit, respektivisht partneritetin midis përfaqësuesve të heliksit së katërfishtë**

Lëndë e mbështetjes financiare në përputhje me Thirrjen Publike janë format e partneritetit që kanë **Marrëveshje partneriteti** të lidhur më parë. Partneritetet duhet të përfshijnë organizata përfaqësuese të heliksit të katërfishtë.

Kriteret për at se kush mund të paraqitet si Partner udhëheqës rregullohen me Thirrjen publike.

Marrëveshjen e bashkëfinancimit MEP-ja e lidh me Partnerin udhëheqës, në përputhje me ligjet në fuqi dhe kushtet e përcaktuara me Programin, Thirrjen publike për Masën 5 dhe Udhëzuesin. Nëse gjatë realizimit të projektit, për të arritur qëllimet, ka nevojë për plotësimin dhe sqarimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella midis partnerëve të projektit, rekomandohet të përgatitet **aneks i marrëveshjes për partneritet**, për çka duhet të informohet MEP-ja.

Nëse gjatë zbatimit të projektit ka tërheqje të njërit prej partnerëve, partneri udhëheqës duhet të informojë MEP-në në afat sa më të shpejtë të mundur. Partneri udhëheqës duhet të propozojë plan për të tejkaluar pasojat e një ndryshimi të tillë. Në rast të tillë, Partneri udhëheqës dhe/ose ndonjë nga partnerët tjerë ka mundësinë të marrë përsipër detyrimet nga partneri që ka hequr dorë gjatë zbatimit, por vetëm nëse dëshmon se një ndryshim i tillë nuk do të shkaktojë ndryshime në qëllimet, respektivisht se nuk do të ketë pasoja në rezultatet e projektit. Për ndryshimin e strukturës së partneritetit, duhet të nënshkruhet aneks i marrëveshjes së partneritetit dhe me kohë duhet të informohet MEP-ja.

Një partneritet mund të parashtrrojë vetëm një aplikim.

### **Ekipi i projektit**

Për zbatimin e suksesshëm të projektit, partnerët e projektit mbledhin ekip projekt, e si udhëheqës i ekipit është një përfaqësues nga Partneri udhëheqës.

Numri i anëtarëve dhe kualifikimeve të anëtarëve të ekipit të projektit rregullohen më hollësisht në Thirrjen publike.

Në rast të ndryshimit të anëtarëve të ekipit që janë propozuar në propozim-projektin, MEP-ja duhet të njoftohet me një shkresë ku të përmenden dhe justifikohen arsyet e ndryshimit. Partneri udhëheqës duhet të sigurojë dëshmi se kualifikimet e anëtarit të ri të propozuar të ekipit nuk janë nën nivelin e personit të punësuar më parë, në përputhje me udhëzimet në Thirrjen publike dhe se anëtari i ri ka të njëjtin nivel ose më të lartë të cilësisë, arsimit dhe përvojës si anëtari i ekipit që zëvendësohet. MEP-ja duhet ta aprovojë këtë ndryshim.

Partnerët e projektit kanë detyrimin në ekipin e projektit të përfshijnë të paktën dy hulumtues të rinj, respektivisht studentë të doktoraturës, të diplomuar në këtë fushë dhe/ose studentë nga viti i fundit i studimeve universitare në fushën shkencore, relevante për temën e propozim-projektit.

## **4. KOHËZGJATJA E PROJEKTIT**

Zbatimi i propozim-projektit për të cilin janë dhënë mjetet financiare përmes Masës 5 mund të jetë deri në 9 (nëntë) muaj.

Partneri udhëheqës, në bazë të arsyeve të justifikuara, mund të kërkojë vazhdimin e kohëzgjatjes së projektit duke parashtruar kërkesë të arsyetuar me shkrim në të cilën do të përmenden arsyet për vazhdimin. Kërkesa duhet të parashtrohet të paktën 30 ditë para skadimit të kohëzgjatjes së projektit.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, MEP-ja mund të aprovojë vazhdimin e zbatimit të projektit më së shumti deri në 2 (dy) muaj. Në rast se merret vendim për vazhdimin e kohëzgjatjes së projektit, vazhdimi i kohëzgjatjes do të fillojë nga dita e miratimit të vendimit për vazhdim.

Në periudhën nga skadimi i kohëzgjatjes së projektit deri në ditën e miratimit të vendimit për vazhdim nga Ministria e Ekonomisë, nuk do të njihen kostot dhe aktivitetet, ndërsa partnerët e projektit janë të detyruar të përmbahen nga bërja e çfarëdo shpenzimesh dhe ndërmarrje të aktiviteteve ose t'i bartin vetë shpenzimet e bëra në këtë mënyrë.

Në rast të vazhdimit të kohëzgjatjes së zbatimit të projektit, nuk mund të rritet shuma e mjeteve të dhëna.

## 5. **AKTIVITETET DHE SHPENZIMET**

### **Aktivitetet e pranueshme të financimit:**

Aktivitetet e pranueshme për financim në kuadër të Masës 5 janë si më poshtë:

- hulumtim dhe zhvillim;
- zhvillimin e linjave pilot/produkteve/dhe ose shërbim-it/eve;
- testimin dhe validimin e produkteve/shërbimeve/procese të reja dhe/ose të avancuara;
- mbrojtjen e pronësisë intelektuale;
- dizajni;
- zhvillimin e shkathtësive dhe trajnimeve;
- diseminimin e përvojës nga projekti i palëve të treta;
- nxitjen e dialogut të vazhdueshëm të akademisë dhe biznesit;
- aktivitetet e qëndrueshmërisë së projektit dhe
- aktivitete të tjera që lidhen me qëllimet e projektit.

Lista e aktiviteteve nuk është shteruese.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i projektit rregullohen me Thirrjen publike.

### **Në përgjithësi për shpenzimet e realizimit të projektit**

Vetëm shpenzimet e shkaktuara për aktivitetet e zbatuara gjatë kohëzgjatjes së projektit, e që janë në përputhje me Buxhetin e aprovuar të projektit do të konsiderohen shpenzime të pranueshme.

Shpenzimet e parashikuara në formularin "Buxheti i projektit" duhet të korrespondojnë me aktivitetet e parashikuara në formularin "Zbatimi i projektit".

Lloji dhe shuma e shpenzimeve operative përcaktohen në formularin "Buxheti i projektit", dhe ato përfshijnë qiranë e hapësirës, shpenzimet e përgjithshme, provizionet bankare (shuma totale e fondeve në zërat e shpenzimeve operative nuk mund të tejkalojë 10% të buxhetit të përgjithshëm të projektit).

Nëse gjatë zbatimit të projektit shfaqen **shpenzime shtesë** që nuk parashikohen në aplikimin e projektit, ndërsa janë të domosdoshme për realizimin e tij, me ç'rast shuma që nevojitet për realizimin e aktivitetit është më e madhe se ajo e parashikuar në aplikimin e projektit dhe buxhetin e projektit, kjo shumë do të duhet të mbulohet nga partneri udhëheqës dhe/ose partnerët e projektit, në përputhje me Marrëveshjen e partneritetit.

Mjetet financiare që pas përfundimit të projektit do të mbeten në kurriz të projektit si të papërdorur, ose nëse ekzistojnë fonde nga llogaria e dedikuar që janë paguar, dhe për të cilat nuk ka konfirmim dhe dëshmi se ato janë përdorur me qëllim në përputhje me aktivitetet e planifikuara në aplikimin e projektit dhe buxhetin e projektit, do të duhet të kthehen në llogarinë e MEP-së.

### **Shpenzimet e pranueshme për realizimin e projektit:**

Shpenzimet e drejtpërdrejta në lidhje me realizimin e projektit:

- Pagat bruto për personat e punësuar te Partnerit udhëheqës, respektivisht partnerët e projektit që janë të angazhuar në ekipin e projektit (shumat e pagave bruto e të punësuarve-të angazhuar në projektin duhet të korrespondojnë me praktikat e vendosura të partnerëve para fillimit të projektit). Këto shpenzime njihen si pjesëmarrje vetjake e partnerëve të projektit.
- furnizimi dhe/ose dhënia me qira e pajisjeve dhe materialeve harxhuese për hulumtim dhe zhvillim;
- Shërbime nga ekspertë/ këshilltarë/ konsulentë/ nënmarrëveshje (për hulumtim, zhvillim, testim, zhvillim të biznesit, trajnim, etj.)/ shpenzime që lidhen me angazhimin e personave të jashtëm (persona fizikë dhe/ose juridikë) për shërbimet për hulumtim dhe zhvillim, testim, zhvillim të biznesit, trajnim, etj.;
- Shpenzime të tjera operative që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e projektit;
- Furnizimi i literaturës, zhvillimi dhe furnizimi i zgjidhjeve TIK.
- Përpilimi i Studimit të projektit të realizuar (Case Study) për promovimin e rezultateve.

Lista e shpenzimeve të pranueshme nuk është shteruese.

### **Shpenzimet e papranueshme për financim**

- Shpenzimet për pagat e të punësuarve te një partner i projektit, të cilët tashmë janë mbuluar nga mjetet e buxhetit;
- Shpenzimet për furnizimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve nga ndërmarrjet vendore publike, përveç shpenzimeve të përgjithshme;
- Shtesat e pagës në formën e regresit për pushimin vjetor, paga e trembëdhjetë, performanca në punë dhe të ngjashme;
- Shpenzimet e interesit ose të borxhit të një pale tjetër;
- Shpenzimet dhe rezervimet për humbjet ose borxhet e kaluara dhe të mundshme në të ardhmen;
- Mbulimi i humbjeve për shkak të këmbimit valutor, taksave dhe gjobave;
- Shpenzimet për ushqim dhe hotelieri;

- Shpenzimet e rekrutimit të personelit (shpenzimet e publikimit të shpalljeve, provizione nga agjencitë e punësimit, shpenzimet që lidhen me përzgjedhjen e kandidatëve, etj.) dhe shpenzimet për risistemim;
- Blerja e tokës ose ndërtesave, duke përfshirë rinovimin.
- Pagesat në para të gatshme për nevojat e projektit;
- Aktivitetet e eksportit (shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me eksportin e produkteve, me themelimin dhe funksionimin e rrjetit shpërndarës, etj.)
- Taksat vjetore për mirëmbajtjen e patentës (duke përjashtuar rastet e justifikuara mirë të mbivlerësuara si shpenzim i lejueshëm gjatë evaluimit të propozim-projekteve).
- Shpenzimet për shërbimet e konsulencës të ofruara nga pronar-i (ët) e partnerëve të projektit, si dhe personat e autorizuar të partnerëve të projektit (drejtuesi/drejtori);
- Shpenzimet për shërbimet e konsulencës të ofruara nga personat e punësuar nga Partneri udhëheqës;
- Qiradhënia e hapësirave afariste nga një qiradhënës i cili merr pjesë në aktivitetet e projektit ose është person i lidhur me një përdorues;
- Furnizimi i automjeteve të mallrave dhe udhëtarëve nga kompanitë që ushtrojnë transportin rrugor të mallrave me qira ose kompensim;
- Shpenzimet për realizimin e aktiviteteve të financuara më parë nga burime të tjera;
- Tatimi i Vlerës së Shtuar (TVSH), në rastet kur subjekti i përzgjedhur ka të drejtë të kthejë TVSH-në.

## **6. APLIKIMI NË THIRRJEN PUBLIKE**

Mjetet financiare sipas Masës 5 jepen në bazë kompetitive sipas Thirrjes së publikuar publike.

Thirrja publike publikohet në ueb faqen e Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës [www.economy.gov.mk](http://www.economy.gov.mk), pas aprovimit nga ministri i Ekonomisë dhe Punës.

Afati për parashtrimin e propozim-projekteve do të përcaktohet në thirrjen publike nga MEP-ja dhe mund të vazhdohet për shkak të rrethanave të justifikuara.

Thirrja publike duhet të përmbajë informacionet e mëposhtme:

- të dhëna për organin që shpallë thirrjen;

- përshkrim të Masës 5, duke përfshirë kriteret e pranueshmërisë së partnerëve të projektit, që mund të shfaqet si Partner udhëheqës, aktivitetet si dhe shpenzimet që janë të pranueshme dhe shpenzimet që nuk janë të pranueshme për financim;
- përshkrimi i rezultateve të pritshme;
- data e publikimit të Thirrjes Publike;
- mënyra e parashtrimit të propozim-projektit dhe dokumentacionit shoqërues;
- kriteret për vlerësimin e projekteve;
- afati për parashtrimin e propozim-projektit;
- buxheti i përgjithshëm për thirrjen;
- informacionet e kontaktit dhe
- të dhëna të tjera të nevojshme për realizimin e Thirrjes publike.

Gjatë aplikimit për marrjen e mjeteve financiare përmes Masës 5, duhet të dorëzohen dokumentet e mëposhtme:

- formular i plotësuar në mënyrë të rregullt "Zbatimi i projektit";
- formular i plotësuar në mënyrë të rregullt "Buxheti i projektit" ;
- biografi të shkurtër të personave që përbëjnë ekipin e projektit të angazhuar në projektin (më së shumti për 5 (pesë) persona) dhe
- dokumente të tjera të përcaktuara më hollësisht me Thirrjen publike.

Mosdorëzimi i formularit të plotësuar "Aplikim i projektit" dhe formularit të plotësuar "Buxheti i projektit" do të jetë arsyeja e refuzimit të aplikimit në fazën e verifikimit administrativ, pa dhënë mundësinë për ta dorëzuar përsëri të njëjtën.

Aplikimi i projektit, buxheti i projektit, biografite si dhe të gjitha dokumentet e tjera duhet të dorëzohen në gjuhën maqedonase. Aplikimet duhet të dorëzohen në formularët e përpiluara nga MEP-ja që publikohen në ueb faqen e MEP-së dhe janë pjesë përbërëse e Thirrjes publike.

Në rast se projekti bazohet në të drejtat ekzistuese të pronësisë intelektuale, Partneri udhëheqës është i detyruar, së bashku me dokumentacionin e projektit, të dorëzojë dëshmi për të drejtën e përdorimit të pronësisë intelektuale në formën e marrëveshjes së licencimit, marrëveshjes së kontributit jomonetar ose llojit tjetër të marrëveshjes që konfirmon se Partneri udhëheqës ose partneri tjetër i projektit ka të drejtë të përdorë pronën intelektuale në të cilën bazohen rezultatet e projektit.

Në rast se partnerët e projektit përzgjidhen për bashkëfinancim përmes Masës 5, para se të marrin Vendim të përfundimtar për bashkëfinancimin dhe/ose para nënshkrimit të Marrëveshjes së financimit, Partneri udhëheqës duhet t'i parashtrorë në MEP dokumentet e mëposhtme:

- marrëveshjet e bashkëpunimit me partnerët e projektit, të vërtetuara në noter,
- informacion për llogari të hapur të dedikuar për projektin dhe
- dokumentacion shtesë me të cilin dëshmohet përmbushja e kushteve të përshtatshmërisë së aplikantit.

Partneri udhëheqës do të sigurojë dokumentet shtesë në afat prej 5 (pesë) ditëve të punës, nga dita e njoftimit të marrë nga MEP-ja.

## **7. EVALUIMI**

### **Kriteret e evaluimit dhe hapat për miratimin e vendimit për bashkëfinancim**

Kriteret themelore për evaluimin e projektit dhe shpërndarjen e mjeteve sipas Masës 5 jepen në Tabelën e evaluimit që është pjesë e Thirrjes publike.

Propozim-projektet shqyrtohen në 4 (katër) hapa:

1. Kontrolli administrativ;
2. Parapërzgjedhja
3. Përzgjedhja dhe
4. Miratimi i vendimit për bashkëfinancim

Të gjitha propozim-projektet që janë dorëzuar në Thirrjen publike shqyrtohen nga anëtarët e Komisionit të verifikimit administrativ. **Komisioni i verifikimit administrativ** përbëhet nga të punësuar në MEP, të cilët i emëron ministri i Ekonomisë dhe Punës. Në fazën e verifikimit administrativ, shqyrtohet nëse dokumentet me të cilat aplikohet janë dorëzuar në kohën e duhur dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në Thirrjen publike.

Në rast të dorëzimit të dokumentacionit të pakompletuar, Partneri udhëheqës ka të drejtë ta plotësojë atë në afat të përcaktuar nga MEP-ja. Nëse partnerët e projektit nuk kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kushtet e përcaktuara në Thirrjen publike, ai do të konsiderohet i pakompletuar.

Komisioni i verifikimit administrativ duhet të ketë të paktën 3 anëtarë, nga MEP-ja.

Për punën e tij, Komisioni për verifikimin administrativ harton procesverbalin.

Pas përfundimit të verifikimit administrativ, dokumentacioni i plotësuar i dorëzohet anëtarëve të Komisionit të vlerësimit.

### **Komisioni i vlerësimit**

Vlerësimi i propozim-projekteve, përzgjedhja dhe vendimi për bashkëfinancimin e projekteve është në kompetencë të Komisionit të vlerësimit.

Komisioni i vlerësimit përbëhet nga të paktën 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët:

- 2 (dy) anëtarë përfaqësues të MEP-së;
- 1 (një) anëtar është përfaqësues i MASH-it dhe
- Të paktën 2 (dy) anëtarë janë ekspertë nga fushat e Specializimit të mençur të përfshira me Thirrjen publike. Numri i ekspertëve varet nga fushat nga të cilat janë marrë aplikimet.

Nëse MEP lidh Memorandume bashkëpunimi me organizatat pjesëmarrëse në zbatimin e Thirrjes publike me mjete financiare dhe/ose ndihmë teknike, atëherë këto organizata kanë të drejtë të emërojnë 1 (një) përfaqësues në Komisionin e vlerësimit.

Vendimin për formimin e komisionit të vlerësimit e nënshkruan ministri i MEP-së.

### **Mënyra e vlerësimit**

Komisioni i vlerësimit i vlerëson propozim-projektet në dy faza: parapërzgjedhje dhe përzgjedhje.

Vlerësimi do të bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në Thirrjen publike.

Në mbledhjen e parë të tij, Komisioni i vlerësimit miraton Rregulloren e punës, në të cilën, në përputhje me Udhëzuesin, rregullon më hollësisht funksionimin e tij. Në mbledhjen e parë, Komisioni zgjedh kryetarin, i cili koordinon më tej punët e Komisionit të vlerësimit. Mbledhja e parë e Komisionit të vlerësimit thirret nga anëtari që është përfaqësues i MEP-së.

Çdo propozim-projekt që do të marrë të paktën 51% të numrit të përgjithshëm të pikëve në fazën e parapërzgjedhjes kalon në fazën e përzgjedhjes. Në fazën e parapërzgjedhjes përpilohet Renditja që u dorëzohet anëtarëve të Komisionit të vlerësimit.

Në fazën e përzgjedhjes, Komisioni i vlerësimit mund të vendosë që disa ose të gjitha partneritetet e parapërzgjedhura duhet të bëjnë prezantim të shkurtër (pitching) dhe të paraqesin projektet e tyre para Komisionit të vlerësimit. Prezantimi i projekteve mund të jetë me prani fizike ose në formën e prezantimit me video. Vendimi për formën e prezantimit merret nga Komisioni i vlerësimit.

Komisioni i vlerësimit harton procesverbalet e dy fazave të vendimmarrjes: parapërzgjedhje dhe përzgjedhje.

Vendimi përfundimtar për përzgjedhjen e projekteve që do të bashkëfinancohen bëhet në mbledhje të veçantë të Komisionit të vlerësimit (mbledhje e përzgjedhjes) duke rivlerësuar sipas kriterëve. Përzgjedhja përfundimtare bëhet duke realizuar një mesatare të pikëve të secilit prej anëtarëve të Komisionit të vlerësimit në fazat e parapërzgjedhjes dhe përzgjedhjes. Nëse ka projekte me të njëjtin numër pikësh në listën përfundimtare të renditjes, përparësi a projekti i rangut më të lartë nga faza e parapërzgjedhjes.

Gjatë miratimit të vendimit përfundimtar për bashkëfinancim, do të merret parasysh edhe shuma e mjeteve në dispozicion në kuadër të Thirrjes publike.

MEP rezervon të drejtën të negociojë me partnerët e projektit në lidhje me përcaktimin e aktiviteteve dhe buxhetit të projektit në bazë të rekomandimeve të marra nga Komisioni i vlerësimit, dhe para nënshkrimit të Marrëveshjes për bashkëfinancim.

MEP-ja rezervon të drejtën të mos japë mjete nëse nuk ka projekte të mjaftueshme cilësore ose nëse kushtet për dhënien e mjeteve nuk plotësohen në përputhje me Udhëzuesin dhe dispozitat e Thirrjes publike.

Afatet për aplikim dhe miratimin e vendimit për bashkëfinancim do të përcaktohen në kuadër të Thirrjes publike.

MEP-ja rezervon të drejtën për të ndryshuar këto afate.

## **8. ZBATIMI I PROJEKTIT**

Partneri udhëheqës ka detyrimin të zbatojë projektin në mënyrë efektive dhe efikase, në përputhje me ligjet, aktet nënligjore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe praktikat e mira. Gjatë zbatimit të projektit, është e nevojshme të ndiqen dispozitat e Udhëzuesit, Thirrjes publike, Zbatimit të projektit dhe Buxhetit të projektit.

Partnerët e projektit, si dhe furnizuesit e përzgjedhur, konsulentët dhe pjesëmarrësit e projektit duhet t'i përmbahen Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, me qëllim parandalimin e korrupsionit dhe dukurive të ngjashme gjatë zbatimit të marrëveshjes.

Në rast të ndërprerjes së Marrëveshjes së bashkëfinancimit, MEP-i rezervon të drejtën t'i kërkojë Partnerit udhëheqës të kthejë një pjesë ose të gjitha mjetet e marra, në përputhje me kushtet e Marrëveshjes.

Çdo tre muaj, partneri udhëheqës duhet të dorëzojë raport mbi zbatimin e projektit dhe kostot e realizuara në MEP me dokumentacion shoqërues, duke ndjekur dinamikën e parashikuar, si dhe raport përfundimtar mbi projektin.

MEP-ja mund të kërkojë takim dhe vizitë për t'u njoftuar me rrjedhën e projektit.

Në përputhje me Marrëveshjen e bashkëfinancimit, Partneri udhëheqës ka detyrimin të hapë **llogari të dedikuar për projektin**.

Në afat prej 15 ditëve pune pas lidhjes së Marrëveshjes së bashkëfinancimit, Partneri udhëheqës është i detyruar të depozitojë në llogarinë e dedikuar pjesën e mjeteve nga pjesëmarrja e vetë partnerëve të projektit të parashikuar për tremujorin e parë të zbatimit të projektit dhe të informojë me kohë për këtë MEP-në.

MEP-ja do të mbajë shënime për servisimin e detyrimeve të Partnerit udhëheqës, si dhe për pagesën me kohë të pjesëmarrjes së vet nga tremujorët në përputhje me Marrëveshjen e bashkëfinancimit.

### **Furnizimi i mallrave, shërbimeve dhe punëve**

Çdo furnizim i mallrave dhe shërbimeve bëhet nga partneri udhëheqës dhe partnerët e projektit e bëjnë në përputhje me praktikën e deklaruar të pranueshme komerciale. Gjatë zbatimit të furnizimeve të parashikuara në projekt, partnerët e projektit duhet të marrin parasysh nevojën ekonomike, efikasitetin, transparencën dhe kohëzgjatjen e procedurës së furnizimit, si dhe cilësinë e mallrave dhe shërbimeve të furnizuara.

Për furnizimet që tejkalojnë 10.000 (dhjetë mijë) euro, partneri udhëheqës ose partnerët e projektit duhet të zbatojnë procedurë me grumbullimin e minimum tre oferta. Dokumentacioni në lidhje me zbatimin e furnizimeve duhet të dorëzohet në MEP në kuadër të raporteve tremujore dhe Raportit përfundimtar. Në rastet e justifikuara mirë, furnizimet mund të bëhen pa procedurën e specifikuar, por vetëm pas aprovimit paraprak nga MEP-ja.

### **Transparenca dhe komunikimi me publikun**

Nëse partneri udhëheqës posedon ueb faqe, ai është i detyruar të publikojë informacion të shkurtër mbi mbështetjen financiare të siguruar nga MEP-ja dhe organizatat e tjera që marrin pjesë në bashkëfinancimin e projektit, nëse ka të tillë.

Të gjithë partnerët e përfshirë në projekt duhet gjithashtu të paraqesin publikisht mjetet e financimit për aktivitetet.

Nëse Partneri udhëheqës publikon ose bën deklaratë për mediat në lidhje me projektin, ai është i detyruar të përmendë mbështetjen e ofruar nga MEP-ja dhe pjesëmarrësit e tjerë në bashkëfinancim (nëse ka).

Nëse publikohet punim shkencor, duhet të deklarohet se projekti është financuar nga MEP-ja.

### **Ndryshimi i projektit dhe ridedikimi i mjeteve nga Buxheti i projektit**

Çdo ndryshim në projekt duhet të justifikohet gjithashtu për të arritur rezultatet e pritshme të projektit. Partneri udhëheqës është i detyruar t'i realizojë shpenzimet në bashkëpunim me partnerët me dinamikë dhe brenda shumave të paraqitura në buxhetin e projektit.

Partneri udhëheqës ka të drejtë të ridedikojë mjetet brenda zërave të buxhetit dhe midis zërave të buxhetit në shumën totale deri në 15% (pesëmbëdhjetë për qind) të buxhetit të përgjithshëm të projektit për të gjithë kohëzgjatjen e projektit në mënyrë që të arrihen rezultatet e pritshme të projektit pa njoftim dhe kërkesë të veçantë në MEP.

Çdo ndryshim në zbatimin e projektit dhe buxhetin e projektit (ndryshimet në planin e aktiviteteve, njerëzit kryesorë të projektit, ridedikimin e mjeteve në shumë më të lartë se 15% (pesëmbëdhjetë për qind) të buxhetit të përgjithshëm të projektit, etj.) duhet të aprovet paraprakisht nga MEP në bazë të kërkesës së parashtruar nga Partneri udhëheqës me shtojcë të buxhetit të rishikuar të projektit.

Ridedikimet e bëra, nëse ka, duhet të deklarohen në Raportet tremujore dhe Raportin përfundimtar të projektit.

Për të gjitha mjetet që nuk janë shpenzuar me dedikim, për të cilat nuk janë dorëzuar dëshmi, ose janë shpenzuar në kundërshtim me ligjet dhe dispozitat e Udhëzuesit dhe Thirrjes publike, MEP-ja rezervon të drejtën të kërkojë kthim të mjeteve nga partneri udhëheqës.

### **Ruajtja e dokumentacionit**

Partneri kryesor duhet të ruajë të gjithë dokumentacionin e projektit që nga fillimi i zbatimit të projektit, që përfshin:

- të gjitha dokumentet zyrtare të komunikimit ndërmjet Partnerit udhëheqës dhe MEP-së gjatë periudhës së aplikimit;
- njoftim për dhënien e mjeteve;
- marrëveshja e dhënies së mjeteve;
- të gjitha dokumentet zyrtare gjatë periudhës së zbatimit të projektit dhe gjatë detyrimit të njoftimit;
- kopje origjinale të raporteve të dorëzuara në MEP;
- njoftimet për aprovimin e raporteve të dorëzuara në MEP;
- kopjet origjinale e të gjitha faturave dhe
- të gjitha dokumentet e tjera duke përfshirë edhe marrëveshjet me palët e treta dhe dëshmitë tjera të pagesës në lidhje me projektin.

Partneri udhëheqës ka detyrimin të ruajë dokumentacionin për të paktën 10 vjet pas përfundimit të projektit.

Të gjitha informacionet në lidhje me marrëveshjet dhe furnizimet në lidhje me projektin duhet të jenë në dispozicion për inspektim për personat e autorizuar nga MEP-ja.

## **9. MONITORIMI DHE EVALUIMI I REZULTATEVE TË PROJEKTIT**

### **Qëllimi dhe metodat e monitorimit dhe evaluimit të rezultateve të projektit**

Qëllimi i monitorimit dhe evaluimit të rezultateve të projektit është të monitorojë ecurinë e projektit dhe zbatimin e aktiviteteve të planifikuara, të konfirmojë se shpenzimet e realizuara janë në përputhje me buxhetin e miratuar të projektit për periudhën e caktuar dhe procedurat e MEP-së, si dhe të vlerësojë rezultatet e arritura pas përfundimit të projektit.

Metodat e monitorimit dhe evaluimit të rezultateve të projektit përfshijnë: shqyrtimin dhe miratimin e raporteve tremujore, shqyrtimin dhe miratimin e Raportit përfundimtar të dorëzuar nga Aplikanti udhëheqës, vizitat në terren tek partneri udhëheqës dhe/ose partnerët e projektit dhe evaluimin e rezultateve të arritura të projektit.

Monitorimi dhe evaluimi i rezultateve të projektit kryhet nga grupet e monitorimit të formuara nga MEP-ja dhe/ose ekspertët e revizionit të emëruar nga MEP-ja ose personat e revizionit të jashtëm nga shoqëritë e autorizuar të revizionit të përzgjedhura me vendim të MEP-së në procedurë adekuate.

Partneri udhëheqës duhet të dorëzojë:

- Raportet tremujore për funksionimin (pjesa përshkuese dhe pjesa financiare) edhe atë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas skadimit të ditës së fundit kalendarike të tremujorit të parë të zbatimit të projektit.
- Raporti përfundimtar (pjesa përshkuese dhe pjesa financiare) edhe atë në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve pas skadimit të ditës së fundit kalendarike të projektit, e brenda të cilit afat partneri udhëheqës duhet të bëjë pagesat për të gjitha aktivitetet e projektit të zbatuara që nga skadimi i ditës së fundit të Marrëveshjes për bashkëfinancim;
- Dëshmi e efekteve dhe aktiviteteve promovuese

Raportet tremujore dhe Raporti përfundimtar do të plotësohen në formularët e përpiluar nga ME, dhe do të dorëzohen nga Partneri udhëheqës;

Raportet i shqyrto komisioni i përbërë nga persona nga MEP-ja dhe/ose ekspertë të revizionit të emëruar nga MEP-ja. Në rast të parregullsive të identikuara të raportimit që mund të korrigjohen, MEP-ja do të njoftojë partnerin kryesor për parregullsitë e identikuara duke kërkuar t'i heqë ato dhe të parashtrijë raport të rishikuar.

Në rast se raportet plotësohen dhe dorëzohen në mënyrë adekuate, MEP-ja aprovon raportet dhe ia dorëzon aprovimin Partnerit udhëheqës.

Personi ose grupi i monitorimit ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente shtesë në lidhje me raportet nga partneri kryesor, si dhe të kryejë vizitë të paralajmëruar në terren për të verifikuar informacionet e dorëzuara.

Raportet e partnerëve, janë pjesë e raportit të grupit të projektit mbi efektin e projektit të secilit partner individualisht.

Ministria e Ekonomisë dhe Punës e ruan për 10 vjet dokumentacionin lidhur me zbatimin e Thirrjes publike.

### **Vizitat në terren**

MEP-ja mund të mbikëqyrë zbatimin e projektit dhe përmes vizitave në terren tek partnerët e projektit.

Vizitat në terren kryhen nga persona/ekipe monitorimi dhe/ose ekspertë revizioni të emëruar nga ministri i Ekonomisë dhe Punës. Në vizitat në terren mund të marrin pjesë edhe përfaqësues të Komisionit të vlerësimit si dhe përfaqësues të organizatave që kanë marrë pjesë në bashkëfinancimin e projekteve, nëse ka të tilla.

Vizitat në terren përfshijnë vizitën në hapësirat afariste të partnerëve të projektit dhe takimin me njerëzit kryesorë të projektit për të mbikëqyrur zbatimin e projektit (p.sh. respektimi i procedurave, arritja e rezultateve të synuara, respektimi i afatit kohor, respektimi i dispozitave të Marrëveshjes së bashkëfinancimit, etj.). Partnerët e projektit janë të detyruar të sigurojnë kushte për kryerjen e mbikëqyrjes dhe vizitave në terren nga Ministria e Ekonomisë dhe Punës në hapësirat e tyre.

Vizita në terren do të jetë e paralajmëruar. Njoftimi për kryerjen e një vizite në terren duhet të dorëzohet të paktën 3 (tre) ditë para zbatimit të vizitës. Nëse është e nevojshme, MEP-ja mund të bëjë gjithashtu vizitë të paparalajmëruar në terren.

Për vizitën në terren, përpilohet raport nga vizita e kryer në terren, i cili përfshin të dhëna për vizitën, personat që morën pjesë në vizitë në terren, dokumentacionin e kontrolluar, vëzhgimet e gjetura nga vizita në terren, parregullsitë e identifikuar, udhëzimet dhe afatet për heqjen e parregullsive eventuale, etj. Partnerit udhëheqës i dorëzohet raport nga vizita e kryer në terren. Në rast të parregullsive të konstatuara, Partneri udhëheqës është i detyruar të ndërmarrë masa në përputhje me udhëzimet dhe afatet e përmendura në njoftimin.

#### **Veprimi në rast të parregullsive të konstatuara**

Gjatë zbatimit të projekteve, përveç personit dhe grupeve të emëruara nga ministri i Ekonomisë dhe Punës, të cilët janë të punësuar në MEP, në monitorim mund të përfshihen edhe ekspertë të jashtëm të revizionit.

Eksperti i revizionit është i detyruar të shqyrtojë dokumentacionin e projektit, të bëjë vizita në terren tek partnerët e projektit dhe të dorëzojë raport dhe mendim profesional në MEP në afat prej 14 ditëve pune nga dita e marrjes së dokumentacionit.

#### **Bashkëpunimi i Partnerit udhëheqës me MEP-në**

Partneri udhëheqës është i detyruar t'u përmbahet procedurave dhe t'i mundësojë MEP-së dhe ekspertëve të bëjnë monitorim dhe evaluim të lehtë mbi zbatimin e projektit.

Partneri udhëheqës është i detyruar t'i mundësojë MEP-së ose personave të autorizuar nga MEP-ja në çdo kohë të bëjnë analizë të zbatimit të projektit, të aktiviteteve të tij dhe rezultateve të arritura, si dhe të bëjnë revizion të projektit të përgjithshëm dhe dokumentacionit financiar. Partneri udhëheqës, me kërkesë të MEP-së, duhet t'i përgatisë dhe dorëzojë të gjitha dokumentet relevante në lidhje me projektin.

#### **Të drejtat dhe detyrimet në lidhje me rezultatet e projektit**

Partnerët e projektit do t'i posedojnë rezultatet e projektit që do të krijojnë në përputhje me Marrëveshjen e partneritetit.

#### **Detyrimet në rast të ndërprerjes së një partneri të projektit**

Në rast të ndërprerjes (likuidimit) të planifikuar të një partneri të projektit ose nëse është parashtruar propozim për fillimin e procedurave të falimentimit kundër një partneri të projektit (në rastet kur kjo është e zbatueshme), Partneri udhëheqës do të dorëzojë njoftim në MEP. Partneri udhëheqës do të njoftojë MEP-në me shkrim për përfundimin e planifikuar ose fillimin e procedurave të falimentimit në afat prej 10 (dhjetë) ditëve nga momenti kur ka mësuar për propozimin e tillë.

Në rast të ndërprerjes së marrëveshjes, MEP-ja rezervon të drejtën të kërkojë kthimin e të gjithë ose një pjese të shumës që MEP-ja ia ka paguar Partnerit udhëheqës.